



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:145822

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453663

P.nr.220A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale ndaj të akuzuarve I.D i akuzuar për veprën penale Sulmi nga neni 184 par 1 dhe E.D. i akuzuar për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3569/23 të datë 21.06.2023 në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 06.11.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta, të dëmtuarit F. D. me mbrojtësin sipas autorizimit av. Shyhrete Shalaku dhe të akuzuarve I. dhe E.D. me datë 08.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. I.D, i biri i A. dhe nëna R., e gjinisë L., i lindur me në fshatin M. e E. Komuna F.K. ku edhe jeton, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.
2. E.D., i biri i I. dhe nëna R., e gjinisë L., i lindur me në P., me vendbanim në fshatin M.E, KK F.K, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

I pandehuri I.D me datën 26.6.2022 rreth orës 18:10 në fshatin M. e E. komuna F.K , tani i dëmtuari F.D. është sulmuar fizikisht nga i pandehuri I.D, për shkak të një mos mosmarrëveshje të më hershme që kishin pasur ndërmjet vete , ashtu që në ditën kritike i pandehuri kishte shkuar në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit dhe në ato qatë me dashje e sulmon të dëmtuarin F. duke e përdor forcën , me ç’ rast e godet me shuplakë në fytyrë të dhe me atë rast ka ndyrë vëllai i tij dhe e ka larguar.

- Me çka ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri E.D.me datën 26.6.2022 rreth orës 18:10 në fshatin M.E., i pandehuri E.D. me dashje dhe me veprimet e tij të kundërligjshme, ka asgjësuar – dëmtuar (thyer) pasqyrën e veturës e tipit “Audi 4 “ pronë e të dëmtuarit F.D , ka vepruar në atë mënyrë që për shkak se paraprakisht i dëmtuari e kishte ngacmuar seksualisht nënën e tij i njëjti nga mllef i dhe nervozë kishte shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit

dhe në ato qaste me dashje kishte dëmtuar edhe një perde e cila ishte e vendosur në derë, me ç' rast të dëmtuarit F.i kishte shkaktuar dëm material në vlerë të pacaktuar.

- Me çka ka kryer veprën penale "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" nga neni 321 paragrafi 1 i KPRK-ës,

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 81 dhe 82 të KPRK-së neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364, 498, 499 të KPPRK-së, të pandehurve u shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Te pandehurve u bëhet me dije se kanë kryer veprë penale të dëmshme dhe nëse serish kryejnë ndonjë veprë të tillë, gjykata do të ju shqiptoi sanksionin penal.

Obligohen të pandehurit secili veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.3569/23 të datë 21.06.2023, ndaj të akuzuarve I.D për veprën penale Sulmi nga neni 184 par 1 dhe E.D. për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 06.11.2024 në praninë e prokurorit të shtetit Blerim Igrishta të dëmtuarit F.D.dhe të pandehurve I.D dhe E.D. ku të njëjtit u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurve.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori të pandehurit u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të akuzuarve, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë. Gjykata konstatoj se të akuzuarit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të akuzuarit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat janë njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve I.D qëndrojnë gjitha

elementet e veprës penale Sulmi nga neni 184 par 1 dhe tek i pandehuri E.D. qëndrojnë gjitha elementet e veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë si dhe shkakun i cili ka qar deri tek kryerja e veprës penale nga të pandehurit. Rrethanë posaçërisht rënduese Gjykata nuk gjeti.

Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarve, ndërsa rrethana rënduese Gjykata nuk gjeti

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 82 të KPRK-se të akuzuarit i gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se vërejtja shqiptuar të akuzuarve është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro për secilin të pandehur.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364, 498, 499 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.220A/23 datë 14.11.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykyese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.